



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Gramoz RUÇI

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË SIGURIMIT
TË DEPOZITAVE PËR VITIN 2019**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar dhe shmangies së krizave të mundshme financiare, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit përfundimtar të shërbimeve bankare, nëpërmjet ndërtimit të urave të komunikimit ndërmjet autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse të sistemit bankar shqiptar;

Duke vlerësuar rolin e ASD-së në përputhje me ligjin nr.133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë” dhe administrimin e Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme,

Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2019 lidhur me:

- Rritjen e gatishmërisë operacionale për një ngjarje të mundshme kompensimi, duke kryer simulime të përgjithshme me pjesëmarrjen e bankave agjente, si dhe simulime teknike me të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit, anëtare të skemës së sigurimit të depozitave.
- Rinovimin e marrëveshjes ekzistuese të bashkëpunimit me Bankën e Shqipërisë, në rolin e saj si autoritet mbikëqyrës, me synim krijimin e një platforme bashkëpunimi për ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe rolet respektive.
- Miradministrimin e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe rolin mbështetës të skemës së sigurimit të depozitave në një rast ndërhyrjeje të jashtëzakonshme.
- Ndërmarrjen e ASD-së për realizimin e projektit për vlerësimin e skemës së sigurimit të depozitave dhe treguesve të saj.
- Bashkëpunimin me ekspertë të propozuar nga IADI-ja dhe kontraktuar përmes FSVC-së, për realizimin me sukses të projektit të vlerësimit të përputhshmërisë së skemës me parimet themelore për një sistem efektiv të sigurimit të depozitave.

- Simulimet teknike të kryera nga ASD-ja me të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit anëtare të skemës, si gjatë procesit të verifikimit në këto subjekte, ashtu edhe në periudha të tjera ndërmjet verifikimeve. Simulimet teknike synojnë të përgatisin të gjithë anëtarët e skemës së sigurimit të depozitave për të raportuar saktë dhe shpejt skedarët për kompensim, në rast të një ngjarjeje sigurimi.

- Bashkëpunimin me Grupin Këshillimor të Stabilitetit Financiar, me qëllim ruajtjen e stabilitetit financiar dhe shmangien e krizave të mundshme financiare nëpërmjet pjesëmarrjes rregullisht në të gjitha mbledhjet e këtij forumi duke raportuar për gatishmërinë e saj operacionale, duke u fokusuar veçanërisht tek ecuria e depozitave të siguruar pranë bankave dhe shoqërive të kursim-kreditit (sh.k.k), burimet financiare në dispozicion për kompensimin e depozitave të siguruar në institucionet financiare anëtare të skemës së sigurimit të depozitave.

- Rishikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit në fuqi me autoritetin mbikëqyrës, duke synuar zhvillimin e mëtejshëm të skemës së sigurimit të depozitave, mbrojtjen e interesave të depozituesve shqiptarë dhe forcimin e stabilitetit financiar në vend përmes konsolidimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në nivel teknik dhe operacional mes ASD-së dhe Bankës së Shqipërisë në rolin e saj si autoriteti mbikëqyrës.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i rekomandon Agjencisë së Sigurimit të Depozitave që gjatë vitit 2020 ta fokusojë punën në këto drejtime:

- Ndjekjen e problematikave të konstatuara gjatë verifikimeve në të gjitha bankat dhe shoqëritë e kursim-kreditit, që janë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave, rekomandimeve dhe afateve të lëna nga ASD-ja, duke mbajtur parasysh rëndësinë e saktësisë së raportimit të skedarëve për plotësimin e objektivit kryesor të Agjencisë, kompensimin e depozituesve në rast të një ngjarjeje kompensimi.

- Hartimin dhe vënien në zbatim të platformave, që synojnë përmirësimin dhe cilësinë e të dhënave të depozituesve duke vendosur afate dhe parametra të caktuar, veçanërisht adresimin e çështjeve të lidhura me numrin personal, mungesa e të cilit është problematike edhe në funksion të plotësimin të objektivave të Agjencisë.

- Përfundimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve për realizimin e planit strategjik 2018-2020, që përmbante tri prioritetet strategjike për Agjencinë në periudhën afatmesme.

- Ndjekjen e efektivitetit dhe ecurisë së mjeteve financiare të fondit, të investuara në përputhje me strategjinë vjetore të investimit për vitet 2018 dhe 2019, miratuar nga Komiteti i Investimeve i Agjencisë, në përputhje me funksionin e ASD-së si administruese e këtyre mjeteve financiare të fondit.

- Të vijohet me verifikimin e efektshmërisë së trajnimeve të punonjësve të bankës, të cilët janë në kontakt me klientelën, si përcjellësit e parë dhe më të rëndësishëm të informacionit për sigurimin dhe kompensimin e depozitave, duke u siguruar për nivelin dhe cilësinë e dijeve të tyre profesionale për sigurimin dhe kompensimin e depozitave bankare.

Miratuar në datën 2.7.2020